

**AKTI I THEMELIMIT**  
**TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“BOUCHERIE DU BOEUF VLORA “SH.P.K**

**Neni 1**

**Emërtimi i shoqerise**

Z Aleks Sadikaj me ID. G81218020L, eshte ortak ishoqerise me pergjegjesi te kufizuar e quajtur “Boucherie Du Boeuf Vlora” shpk. Shoqeria eshte person juridik dhe ushtron veprimtarine ne baze te Ligjit Nr.9901 ,date 14.04.2008“ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”.

**Neni 2**

**Selia e shoqerise**

Selia e shoqërisë “Boucherie Du Boeuf Vlora” shpk është ne Vlore, Lagjja “29 Nentori”, Rruga “Gjergj Kastrioti”, Objekti 7, Vlore. Shoqëria mund të ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj. Shoqëria sipas parashikimeve të këtij statuti dhe legjislacioni në fuqi, mund të hapë si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, qendra dhe përfaqësi apo filiale, degë dhe shoqëri të tjera.

**Neni 3**

**Kohëzgjatja e veprimtarise**

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin tregtar do te jete subjekt i te drejtes shqiptare deri me 06.01.2032. Ky afat mund të ndryshohet një ose më shumë herë, me vendim të ortakut te shoqerise.

**Neni 4**

**Objekti**

Objekti i shoqërisë do te jete si vijon :Aktivitete ne fushen import eksport te produkteve bujqesore dhe blektorale, ushqimore, industrial , pije alkolike dhe te konsumit te gjere. Mbareshtimi i kafeshve blektorale te organizuar ne ferma te medha agrolektorale si gjedh, dhen , dhi, shpend , etj . Ngritjen e industrise perpunuese per prodhimet te mishit dhe te qumeshtit ,sallamerise e te ngjashme dhe zhvillimin e aktivitetin te thertoreve dhe baxhove perpunuese, paketimin, amballazhim dhe tregtimin e tyre produkteve qe dalin nga ky aktivitet. Sigurimin dhe furnizimin e fermerve me impute cilesore ne bujqesi dhe ushqimore ne blektori dhe medikamenteve per bujqesi dhe blektori.

**Neni 5**

**Kapitali i regjistruar**

Vlera e kapitalit te kontribuar dhe i regjistruar ne shoqëri është 100.000 leke (Njeqindmije ) i cili zoterohet 100 % nga ortaku z Aleks Sadikaj. Kapitali i shoqerise mund te rritet apo te zvogelohet me vendim te Asamblese se pergjithshme te shoqerise .



**Neni 6**  
**Drejtimi dhe administrimit**

Organet drejtuese te shoqerise jane : Asambleja e pergjitheshme e shoqerise dhe Administratori i shoqerise . Shoqeria tregtare “Boucherie Du Boeuf Vlora” shpk do te drejtohet nga nje administrator qe emerohet me vendim te Asamblese te Shoqerise. Administratori i shoqerise per periudhen 5 vjecare duke filluar nga data e sotme deri me daten 06.01.2027 do te jete Aleks Sadikaj

Vlore me , 06 Janar 2022

**PER ASAMBLENE E SHOQERISE “BOUSERIE DU BOEUF VLORA”shpk**

Aleks Sadikaj

Sadikaj Aleks

